



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1365/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit, Viva Fresh shpk me seli në fshatin Suhodoll Komuna e Graçanicës të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SHA Pro Juris në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Zyra e Tatimit në Pronë, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit-paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.272/24 të datës 04.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit-paditësit Viva Fresh shpk me seli në fshatin Suhodoll Komuna e Graçanicës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.272/2024 i datës 04.06.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.273/24 të datës 04.06.2024 është Hedhur Poshtë padia me shenjen KF.nr.272/24 dhe propozimi-kërkesa e paditësit-propozuesit Viva Fresh shpk me seli në fshatin Suhodoll Komuna e Graçanicës, për shtyrjen e ekzekutimit të aktit

administrativ-vendimit nr.3/29.03.2024 apo nr.protokolli 04/277 datë 29.03.2024, kundër të paditurës Komuna e Malishevës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Tatimit në Pronë, si e parakohshme.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit - propozuesit, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet ankesa e paditësit, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.272/2024 i datës 04.06.2024, dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë gjen se dhoma e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit nr.3/29.03.2023 apo nr.protok.04/277 datës 29.03.2024, ka Hedhur poshtë padinë dhe propozimin për shtyrje te ekzekutimit të këtij akti administrativ, me arsyetimin se paditësi nuk ka respektuar procedurën e ankesës pranë të paditurës respektivisht nuk ka bërë ankesë kundër vendimit nr.3/29.03.2024, në Komisionin e Ankesave pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, përmes Zyrës së tatimit në pronë në Komunën e Malishevës, por ka ushtruar padi në gjykatë me propozim për shtyrje të ekzekutimit të tij. I njëjti me plotësimin e padisë dt.29.05.2024 ri-konfirmon përsëri propozimin e lartcekur duke kërkuar anulimin dhe shtyrjen e të njëjtit vendim nr.3/29.03.2024, nga i cili rrjedh se i njëjti nuk është akt administrativ përfundimtar , pra nuk i ka shtjerr të gjitha mjetet e rregullta juridike pranë të paditurës, prandaj gjykata në

bazë të nenit 34 par.1 pika 1.1 e LKA-së, e ka Hudh poshtë padinë dhe propozimin për shtyrje te ekzekutimit, si të parakohshme

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të dhomës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret paditësi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike administrative, për të ngrit konflikt administrative me padi në gjykat.

Dispozita e nenit 13 të LKA-së, parasheh: 1.Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë se kur pala mund të inicoj konflikt administrativ në gjykatë. Në rastin konkret propozuesi-paditësi, ka ushtruar padi me datën 11.04.2024 në gjykatë dhe propozimin për shtyrjen e aktit administrativ të paditurit Komuna e Malishevës-Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Zyra e Tatimit në Pronë, me të cilat ka kërkuar anulimin dhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit nr.3/29.03.2023 apo nr.protok.04/277 datës 29.03.2024. Kolegji vlerësoi se ky vendim i kundërshtuar me padi nga paditësi, nuk është akt administrativ përfundimtar i nxjerr në procedurën administrative, për arsye se paditësi ka pasur të drejtën ligjore ta kundërshtoj këtë vendim të paditurës, në organin administrativ të shkallës së dytë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të nenit 31 paragrafi 9 i Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, që parasheh:

Personi mund të ankimojë vendimin e komunës në Ministrinë e Financave brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data kur vendimi i komunës konsiderohet të jetë pranuar nga personi.

Meqë paditësi nuk ka ushtruar ankesë në organin administrativ të shkallës së dytë, por ka ushtruar padi ndaj vendimit të nxjerr nga organi administrativ i shkallës së parë, pa i shteruar mjetet e brendshme juridike, Kolegji vlerësoi se pretendimet ankimore të

propozuesit- paditësit, në ankesë, ndaj aktvendimit të Dhomës së shkallës së parë, janë të pabazuara në ligj, dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa, ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk mund të vendoset për themelësinë e padisë dhe propozimit për shtyrje të një akti administrativ, i cili nuk është akt administrativ përfundimtar, dhe me të drejt dhoma e shkallës së parë ka vendosur në vështrim të nenit 34 të LKA-së, kur ka Hedh poshtë padinë me shenjen KF.nr.272/24 dhe propozimin-kërkesën e paditësit-Viva Fresh shpk me seli në fshatin Suhodoll Komuna e Graçanicës, për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ-vendimit nr.3/29.03.2024 apo nr.protokolli 04/277 datë 29.03.2024, kundër të paditurës Komuna e Malishevës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Tatimit në Pronë, si e parakohshme.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se paditësi nuk ka respektuar dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 31.9 e Ligjit 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, për ta ankimuar vendimin e të paditurës, prandaj nuk mund të pranohen pretendimet në ankesë sa i përket ligjshmërisë së vendimit të paditurës të kundërshtuar me padi.

Kolegji vlerësoi se Dhomat e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e Hudhjes poshtë të padisë dhe kërkesës së paditësit-propozuesit, si të parakohshme, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit Komuna e Malishevës-Drejtoria Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, dhe se nuk është cënuar ligji në dëm të ankuesit.

Sipas vlerësimit të Dhomave të shkallës së dytë, aktvendimi i atakuar i dhomës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1365/24 datë 22.07.2024

Kryetari i Kolegjit

Krenar Berisha